

Renata Neli

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë Zyrës së Komisionerit, që prej muajit shkurt të 2024.

Znj. Neli ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në vitin 2008 e diplomuar me titullin “jurist” si dhe ka përfunduar ciklin e studimeve të nivelit master shkencor në marrdhënie ndërkombwtare në vitin 2010.

Karrierën e saj profesionale, e ka nisur në vitin 2009 duke mbajtur pozicione të ndryshme në administratën publike si specialist, përgjigjës sektori dhe drejtor drejtorie, me nje eksperiencë pune prej 14 vitesh në Ministrinë e Brendshme dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Znj. Neli është trajnuar profesionalisht në fushën e hartimit të legjislacionit, çështjeve të sigurisë, menaxhimit të burimeve njerëzore etj.